

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE PRONES:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Kushtet e pergjithshme te kontrates per Sigurimin nga Zjarri, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht **"Kushtet e Sigurimit"**.

Shoqeria e sigurimeve **INTERSIG**, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht **"Siguruesi"**.

Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i te cilit do te mbulohet sipas ketyre Kushteve te Sigurimit nga Zjarri, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht **"i Siguruari"**.

Personi fizik ose juridik, qe ka interes pasuror mbi objektin e siguruar dhe ne dobi te te cilit lidhet kontrata, ketu me poshte do te quhet **"perfituesi"**.

OBJEKTI I SIGURIMIT

1. Siguruesi ofron Sigurimin nga Zjarri per objektet e meposhtme:

a. pasurine e paluajtshme, ndertesat dhe pjese te tjera te njesise;

b. pasurine e luajtshme.

2. Siguruari mund te siguroje prane Siguruesit pasuri qe e ka ne pronesi te tij ose ne cdo forme tjeter te pronesise me kusht qe te jete nje kontrate sipas kerkesave ligjore me pronarin e pasurise apo sendit.

3. Njesi e siguruar do te konsiderohet te jene ndertesat ose dhomat e ndertesave ose vendet e percaktuara si te tilla ne kontrate. Nuk do te mbulohen ne sigurim sendet vetiake qe u perkasin dhe perdoren nga punonjesit, pervec rasteve kur jane percaktuar shprehimisht ne Policen e Sigurimit.

4. Pasuria e luajtshme, si rregull do te mbulohet vetem per njesine e siguruar.

5. Sigurimi i pajisjeve nuk do te perfshije:

a. Specimenet, modelet ose kampionet, ose stampat per prodhimin e nje lloji te vecante produkti qe nuk nevojiten me per prodhimin vijues;

b. mjetet motorrike, rimorkiot ose traktoret qe kerkojne regjistrim.

6. Makinat e fatit, makinat automatike per thyerjen e terheqjen e parave, perfshire permbajtjet e tyre do te mbulohen ne sigurim vetem ne se per to eshte rene dakord shprehimisht ne kontrate.

8. Objektet e meposhtme do te sigurohen vetem ne kasaforta sipas llojit te pershkruar ne kontrate:

a. kartmanedha;

b. dokumenta, si libreza kursimesh, libra llagarie, letra me vlere, etj.

c. pulla poste;

d. monedha e medalje;

e. metale te cmuar te paperpunuar dhe objekte te prodhuara nga metale te cmuar, pervec objekteve qe sherbejne si zbukurime dhome;

f. bizhuteri, perla e gure te cmuar;

g. objekte per te cilat eshte rene dakord ne menyre te vecante.

9. Kartmonedhat do te mbulohen gjate oreve te punes deri ne nje shume te percaktuar shprehimisht ne kontrate, pavaresisht se ata nuk jane vendosur ne kasaforte, sipas llojit te parashikuar ne kontrate.

RREZIQET E SIGURIMIT

10. Siguruesi demshperblen te Siguruarin per humbjen, demtimin ose shkaterrimin e pasurise se siguruar ne menyre te papritur, te paparashikuar dhe aksidentale si pasoje e:

a. zjarrit

b. rrufese

c. eksplozionit

- d. perplasjes ose renies se nje avioni, pjeseve ose ngarkeses se tij
- e. perpjekjeve per shuarjen e zjarrit, prishjeve ose levizjeve ne lidhje me cdo njerin prej ngjarjeve te mesiperme ne kufirin deri 3 % te shumes se siguruar:

11. Rreziket e mbuluara percaktohen si me poshte:

- a. "Zjarr" do te konsiderohet te jete nje forme e djegies me flake e te mirave materiale jashte vatres qe ekziston qellimisht per te, e afte te vetepërhapet dhe te vetezgjerohet.
- b. "Rrufe" do te konsiderohet te jete nje shkrepje e rrufese, e cila godet nje objekt drejtperdrejt.
- c. "Eksplizion" do te konsiderohet te jete nje clirim i papritur i energjise i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve ne perpjekje per zgjerim.

Shperthimi i nje ene (ngrohese, tubaciane, etj.) do te merret ne konsiderate si i tille ne se paret i enes eshte demtuar ne ate shkalle qe ben te mundur barazimin e papritur te presionit brenda dhe jashte enes.

Ne se shkak per shperthimin brenda enes eshte nje reaksion kimik, atehere do te demshperblehet cdo demtim i enes, edhe ne se paretet e saj nuk jane shkaterruar.

• PERJASHTIME

12. Nuk do te mbulohen demet e shkaktuara nga improvizime.

13. Nuk do te mbulohet fitimi i munguar dhe demet vijuese te cdo lloji dhe natyre te tilla si demet per shkak te vonesave, moskryerjes, humbjes se kontrates, gjobat etj.

14. Nuk do te mbulohen demet e meposhtme:

- a. demtimi nga zjarri i objekteve te siguruara shkaktuar nga venia e tyre ne zjarre utilitare (zjarre perdorimi ose sherbimi) ose nga trajtimi i tyre me nxehte; kjo do te zbatohet gjithashtu per objektet ne te cilat ose permes se cilave prodhohet ose permirohet zjarri ose nxehtesia utilitare;
- b. djegiet siperfaqesore, pervec se kur shkaktohen nga njeri prej rreziqeve te mbuluara ne nenin 10;
- c. demi ne motoret me djegie te brendshme shkaktuar nga shperthimet e ndodhura brenda dhomes se djegies;
- d. demi i shkaktuar ne kontaktet e celesave elektrike si rrjedhoje e presioneve te gazrave qe lindin brenda tyre;
- e. demi ne cdo makineri dhe aparature elektrike, ose ne cdo pjese te instalimit elektrik shkaktuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit (p.sh. si pasoje e mbirrymes, tejkalimit te kufinjve normale te tensioni, mbitensionit ose nentensionit, defekteve te izolimit si qarqe te shkurtera, kontakte trupore ose defekte tokezimi; kontaktit te pamjaftueshem, mosfunksionimit te instalimeve te matjes, kontrollit ose sigurise);
- f. demi ne cdo makineri dhe aparature elektrike, ose ne cdo pjese te instalimit elektrik si pasoje e rrufese, nese ky dem nuk eshte shkaktuar nga goditja direkte e rrufese;
- g. demi nga zjarri, i cili shkaktohet nga termeti;
- gj. demi shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rende e te Siguruarit;
- h. demi shkaktuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashese. Me veprime (akte) keqdashese do te kuptohet humbja, shkaterrimi ose demtimi (shkaktuar nga zjarri, eksplozioni ose veprime te tjera) e Pasurise se Siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga demtimet keqdashese te cdo personi ose grup personash, pavaresisht nese nje akt i tille eshte bere ose jo si pasoje e prishjes se qetesise publike.
- i. demi i shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rende e anetareve madhore te familjes se te Siguruarit

15. Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimin e objekteve te siguruara ose shpenzimet e siguruara te lindura ose te shkaktuara drejtperdrejt ose indirekt si pasoje :

- a. shperthimit berthamor, rrezatimit berthamor dhe ndotjes radioaktive;
- b. luftes se cdo lloji, invazionin, luftime te tjera te armatosura pavaresisht ne se eshte deklaruar lufta ose jo, luften civile;

- c. turbullira civile, revolucionere, levizje separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puge, grushte shteti, eksode;
 - d. konfiskime, rekuizime, shtetezime te detyruara te kryera me urdher te cfaredolloj qeverie apo autoriteti shteteror;
 - e. trazirat, greva, sabotimi, terrorizmi. Terrorizem do te konsiderohet kryerja e veprimeve te dhunshme ndaj pasurise nepermjet vjedhjeve, demtimeve e shkaterrimeve masive qe kane si qellim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikes e te pasigurise se publikut;
 - t. shpalljen e ligjit te luftes, deklarimit dhe vendosjes se gjendjes se jashtezakonshme, anarkia ose mosfunksionimi i shtetit, qofte edhe ne pjese te caktuara te vendit.
- 16.** Nese ne rastin e nje demi Siguruesi perdor te drejten e tij per te mos demshperblyer ne baze te perjashtimeve te nenit 15, i Siguruari do te jete pergjegjes per te provuar se demi qe ka ndodhur nuk ishte shkaktuar direkt ose indirekt ne lidhje me keto perjashtime.

• **SHPENZIME TE MBULUARA**

- 17.** Siguruesi do te demshperbleje shpenzimet perfshire edhe ato pa efekt, qe i Siguruari i ka quajtur te nevojshme te kryeje per te menjanuar ose minimizuar demin (neni 53 i Kushteve te Pergjithshme). Kompensimi i ketyre shpenzimeve se bashku me demshperblimin per njesite e siguruar nuk do te kaloje shumen e siguruar per njesi. Ne rastin e nensigurimit shpenzimet do te rimbursohen ne te njejtin perpjestim si demtimi, pavaresisht nga udhezimet e dhena nga Siguruesi. Nuk do te demshperblehen shpenzimet per sherbimet e kryera nga njesite zjarrfikese ose persona te tjere te detyruar per te dhene ndihme ne interes te popullates si dhe kur Siguruesi provon se mjetet e perdorura dhe shpenzimet e bera nga i Siguruari jane perdorur ose jane bere pa kujdes.
- 18.** Siguruesi do te rimbursoj shpenzimet qe kryhen ne vijim te demit si shpenzimet e pastrimit ne vendndodhjen e demit, perfshire prishjen e pjeseve te pavlefshme heqjen e mbeturinave dhe mbetjeve te tjera ne vendin me te afert te hedhurinave dhe shpenzimet e depozitimit ose shkaterrimit te tyre (shpenzimet e prishjes dhe heqjes se mbeturinave); brenda nje limiti te percaktuar ne Policen e Sigurimit, sipas nje preventivi, por jo me shume se 1% e shumes se siguruar, sidoqofte, nuk do te mbulohen shpenzimet e pastrimit nga ndotja e tokes ose e ujit.

• **VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR**

- 19.** Vlera e siguruar e ndertesave do te jete:

- a. vlera e zevendesimit; Vlera e zevendesimit do te jete vlera lokale e ndertimit duke perfshire shpenzimet e arkitektit dhe shpenzime te tjera te projektimit;
- b. vlera aktuale; Vlera aktuale do te jete e barabarte me vleren e zevendesimit te nderteses minus nje zbritje ne perputhje me gjendjen aktuale te saj, ne vecanti me shkallen e amortizimit;
- c. vlera e tregut; Vlera e tregut do te jete e barabarte me cmimin e mundshem te shitjes se nderteses ose vleren e materialit qe mund te perfitoje i Siguruari nga prishja e saj.

- 20.** Vlera e siguruar e makinerive dhe pajisjeve do te jete:

- a. vlera e zevendesimit; Vlera e zevendesimit do te jete vlera per t'u paguar per blerjen ose prodhimin e objekteve te te njejtit tip dhe cilesi ne nje gjendje si te reja. cilado qofte shuma me e ulet;
- b. vlera aktuale; Vlera aktuale do te jete e barabarte me vleren e tyre te zevendesimit minus nje zbritje ne perputhje me gjendjen e tyre. ne vecanti me shkallen e amortizimit;
- c. vlera e tregut; Vlera e tregut do te jete e barabarte me cmimin e mundshem te shitjes se objektit ose vleren e materialit qe mund te perfitoje i Siguruari nga shitja e pjeseve te tij.

- 21.** Vlera e siguruar e:

- a. mallrave te prodhuara nga i Siguruari, edhe ne se nuk jane perfunduar;
- b. mallrave qe tregtohen nga i Siguruari;
- c. lendeve te para;
- d. produkteve natyrore; do te jete shuma qe duhet paguar per blerjen ose prodhimin e objekteve te te njejtit lloj dhe cilesi, cilado qofte shuma me e ulet.

e. sendeve dhe paisjeve shtepiake do te jete vlere e tyre e zevendesimit.

22. Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e sigurimit. Baza mbi te cilen do te percaktohet shuma e siguruar do te vendoset ne Policen e Sigurimit.

a. Per ndertesat;

-Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e zevendesimit te saj.

-Ne qofte se vlere aktuale eshte me e vogel se 80% e vleres se zevendesimit, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren aktuale.

-Ne qofte se vlere e tregut eshte me e vogel se vlere aktuale, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren e tregut. **b.** Per makineri dhe paisje;

-Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e zevendesimit te tyre.

-Ne raste te vecanta kur nje makineri ase grup makinerish ose paisjesh nuk mund te perdoren me ose nuk jane te perdorshme per qellimin e te Siguruarit, shuma e siguruar do te jete vlere e tregut.

c. Per mallra, lende te para etj. ;

-Shuma e siguruar da te jete e barabarte me vleren maksimale te tyre, e cila perfaqeson vleren maksimale te mundshme te mallrave te depozituara, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.

-Ne raste te vecanta, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren mesatare te tyre, e cila perfaqeson vleren mesatare qe i Siguruari parashikon te kete gjate vitit, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.

23. Ne rast te sigurimit ne" baze te rrezikut te pare", i cili do te deklarohet shprehimisht ne Palicen e Sigurimit, shuma e siguruar do te perfaqesoje nje pjese te vleres se plote dhe Siguruesi do te paguaje ne rast demi deri ne kete shume te siguruar, duke mos zbatuar kushtin e nensigurimit. Primi i sigurimit do te jete me i larte nga ai i llogaritur per sigurimin ne baze te vleres se plote.

• **POLICA E SIGURIMIT**

24. Polica e sigurimit (deshmia e sigurimit) qe Siguruesi i leshon te Siguruarit, verteton lidhjen e kontrates se sigurimit.

25. Ne se Polica e Sigurimit humbet ose demtohet ne masen qe behet e pavlefshme, me kerkesen dhe shpenzimet e te Siguruarit, Siguruesi duhet te leshoje nje dublikate te saj.

26. Kontrata e Sigurimit lidhet ne baze te kerkeses me shkrim te. te Siguruarit. Siguruesi leshon Policen e Sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te Pyetesorit dhe Kerkeses per Sigurim dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari. Kerkesa, njoftimet e deklarimet e tjera te te Siguruarit i bashkengjiten Polices se Sigurimit dhe jane pjese perberese e saj. I Siguruari eshte pergjegjes lidhur me saktesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera prej tij.

27. Siguruesi ka te drejte te verifikojte vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te te Siguruarit dhe te kryje inspektime per saktesine te dhenash.

• **PERIUDHA E SIGURIMIT**

28. Periudha e sigurimit si rregull eshte jo me pak se nje vit, pervec rasteve kur ne Policen e Sigurimit percaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj, perjashtuar raste te tilla si ekspozita, panai etj.

29. Mbulimi ne sigurim fillon ne oren 24.⁰⁰ te dites se percaktuar si dite e fillimit ne Policen e Sigurimit, me kusht qe te jete paguar me pare primi i sigurimit ose kesti i tij i pare.

Mbulimi ne sigurim perfundon ne oren 24.⁰⁰ te dites se percaktuar si dite mbarimi ne Policen e Sigurimit.

30. Pergjegjesia e Siguruesit do te filloje ne momentin kohor te percaktuar ne police, edhe nese pagesa e primit te sigurimit kryhet me pare.

- **PRIMI SIGURIMIT**

31. I Siguruari detyrohet ti paguaje Siguruesit primin e sigurimit sipas shumave dhe afateve te percaktuara ne kontrate.

32. Pagesa e primit te sigurimit behet prane agjencise se Siguruesit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit

Pagesa do te quhet e kryer ne momentin e kalimit te shumes se caktuar ne llogarine e Siguruesit.

33. Primi i sigurimit paguhet ne monedhen e percaktuar ne Policen e Sigurimit

34. Primi i sigurimit mund te paguhet teresisht ose me keste, sipas ketyre rregullave

a. kur periudha e sigurimit eshte nje vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet njeheresh;

b. kur periudha e sigurimit eshte mbi nje vit, si rregull, primi i sigurimit mund te paguhet me keste, gje per te cilen bihet dakort ne Policen e Sigurimit

35. Ne rastin e pageses se primit te sigurimit me keste;

a. shuma e kestit te pare do te jete jo me e vogel se 50 per qind e shumes se pergjithshme;

b. data e pageses se kestit te dyte do te caktohet jo me vone se pese muaj nga data e hyrjes ne fuqi te kontrates se sigurimit;

c. kesti i fundit do te paguhet jo me vone se tre muaj nga data e mbarimit te afatit te Polices se Sigurimit.

Ne rast te pageses se primit te sigurimit me keste, shuma e primit do te shtohet ne nje perqindje te rene dakort midis paleve, por jo me pak se 10 per qind e primit total te sigurimit

d. kur polica e sigurimit eshte lidhur per nje periudhe disa vjecare, primi I sigurimit do te paguhet me keste vjetore

36. I Siguruari detyrohet t'i paguaje Siguruesit primin e sigurimit ne afatet e caktuara ne Policen e Sigurimit. Ne se primi ose kesti i pare i tij nuk paguhet ne afat, mbulimi ne sigurim pezullohet deri ne oren 24.⁰⁰ te dites qe i Siguruari paguan shumen qe detyrohet.

Kur i Siguruari nuk paguan primet ne vazhdim sipas afateve te caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.⁰⁰ e dites se pesembedhete mbas mbarimit te afatit te pagimit dhe Siguruesi ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e Polices se Sigurimit. Humbjet dhe demtimet e vertetuara brenda afatit te mesiperm demshperblehen vetem pasi te jete zbritur shuma e kesteve vijuese te primit te sigurimit.

37. Mospagimi ne kohe i kestit te dyte te primit te sigurimit sjell pasojat e meposhtme:

a. Siguruesi ka te drejte te zgjidhe kontraten e sigurimit;

b. demshperblimin e reduktuar ne masen 50 per qind per humbjet dhe demtimet e vertetuara perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit;

c. kthimin nga i Siguruari te demshperblimeve te paguara ne masen 50 per qind per cdo humbje apo demtim te vertetuar perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit.

38. Kur pasuria e siguruar kalon ne pronesine e nje personi tjetër, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Ne kete rast primi i paguar i kthehet te siguruarit ne perpjestim me kohen qe mbetet deri ne mbarim te afatit te kontrates.

- **PJESA E ZBRITSHME**

39. Ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit do te zbatohet pjese e zbritshme dhe/ose franshize. Per cdo rast demi Siguruesi do te zbrese nga demshperblimi i llogaritur pjesen e zbritshme te percaktuar ne Policen e Sigurimit ne shume absolute ose ne perqindje. Siguruesi nuk do te paguaje deme te vecanta qe jane nen shumeri e percaktuar si franshize ne Policen e Sigurimit. Masat e pjeses se zbritshme dhe franshizes do te percaktohen ne Policen e Sigurimit.

- **DETYRIME**

40. I Siguruari, ne kohen e lidhjes se kontrates se sigurimit, duhet te informoje me shkrim Siguruesin per te gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe qe jane thelbesore per vleresimin e rrezikut.

Rrethanat janë thelbësore në se ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të perfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendose.

Nëse i Siguruari me qellim nuk e përmbush këtë detyrim, Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatit të sigurimit si dhe zgjidhjen e kontratës së sigurimit. Siguruesi mund gjithashtu të zgjidhë kontratën e sigurimit nëse i është dhënë informacion i gabuar. Primi i sigurimit nuk i kthehet të Siguararit.

Në rast demit, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhenie demshperblimi kur shkak i demit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur atij nga i Siguruari.

Keto dispozita janë të vlefshme edhe për Perfituesin nëse vertetohet nga Siguruesi se ai kishte dijeni për pasaktesinë e deklarimeve ose harresave në lidhje me rrezikun.

41. Pas plotesimit të kërkesës për sigurim, i Siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit.

I Siguruari duhet të informojë menjëherë me shkrim Siguruesin për çdo shtim të rrezikut për të cilin vihet në dijeni, edhe nëse një shtim i tillë ndodh pa pelqimin e tij.

Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore në se ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të perfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendose.

Në rast të mosnjohëmit të Siguruesit, ky i fundit ka të drejtë të lirohet nga detyrimi për dhenien e demshperblimit.

42. Nëse i Siguruari ndermerr ose ndryshon një veprimtari të cfarëdo lloji apo madhësie, ai duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin. Nëse ndermarrja apo ndryshimi i veprimtarisë përfshin shtim të rrezikut zbatohen parashikimet e nenit 41. Nga dita që është ndermarre ose ndryshuar veprimtaria, Siguruesi do të ketë të drejtën për një tarifë primi me të lartë. Kjo nuk do të zbatohet nëse Siguruesi është liruar nga plotesimi i detyrimit të tij në rast demit për shkak të shtimit të rrezikut.

43. I Siguruari duhet:

a. të plotesojë të gjitha kërkesat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri përshkruar në rregullore, dispozita ose në kontratë;

b. të ketë të regjistruara letrat me vlerë dhe dokumenta të tjera, koleksione dhe objekte të tjera për të cilat janë parashikuar që të kryhen regjistrime, dhe t'i ruajë ato në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi të demtohen ose humbasin së bashku me objektet e siguruara.

44. Nëse i Siguruari nuk arrin të plotesojë kushtet e përcaktuara me siper, Siguruesi, brenda një muaji nga dita që ka marrë dijeni, mund të zgjidhë kontratën e sigurimit duke e njoftuar të Siguararin me shkrim. Siguruesi do të lirohet nga detyrimi për dhenien e demshperblimit nëse shkak i demit ose humbjes është mosplotesimi nga i Siguruari i detyrimeve me qellim ose nga neglizhenca e rende.

• INTERESI I SIGURUAR

45. Nëse interesi i siguruar pushon së ekzistuari pas fillimit të sigurimit si rrjedhojë e një akti lufte ose një veprimi administrativ në rast lufte ose nëse pushimi i interesit është pasoje e paevitueshme e luftës, Siguruesi ka të drejtë të mbajë pjesën e primit që i perket periudhës së mbulimit të rrezikut.

46. Nëse interesi i siguruar pushon së ekzistuari për shkak të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, Siguruesi ka të drejtën e primit për të gjithë periudhën e sigurimit.

• SIGURIME TE TJERA

47. Nëse i Siguruari kryen sigurim tjetër kundrejt rreziqeve të siguruara për mbulimin e objekteve të siguruara në këtë kontratë, ai duhet t'i njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesit emrin e siguruesit tjetër dhe shumën e siguruar.

Nese, i Siguruari, me dashje ose per shkak te pakujdesise, nuk ploteson detyrimet e paragrafit te mesiperm, atehere Siguruesi ka te drejten e zgjidhjes se kontrates se sigurimit dhe te mospagimit te demshperblimit.

48. Nese eshte percaktuar pjese e zbritshme dhe ekziston sigurim tjeter, atehere masa e demshperblimit qe perfiton i Siguruari nga te gjitha kontratat nuk mund te jete me e larte se sa masa e humbjes minus pjesen e zbritshme.

49. Nese i Siguruari kryen sigurime te tjera me qellim qe te arrije perfitime te paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

• **MBISIGURIMI**

50. Nese shuma e siguruar e tejkalon ndjeshem vleren e sigurimit, atehere si Siguruesi ashtu edhe i Siguruari mund te kerkojne zvogelimin e shumes se siguruar, dhe primi i sigurimit do te pakesohet perkatesisht.

51. Nese i Siguruari lidh kontraten e sigurimit me qellim qe te arrije perfitime te paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka te drejten e mbajtjes se primit te sigurimit.

• **NENSIGURIMI**

52. Nese ne momentin menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit shuma e siguruar eshte me e ulet se vlera e sigurimit, demshperblimi i llogaritur sipas neni 58 do te shumezohet me koeficientin e nensigurimit, i cili percaktohet si raport i shumes se siguruar ndaj vleres se sigurimit.

• **NGJARJA E SIGURIMIT**

53. Ne rastin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, i Siguruari duhet:

a. te njoftoje me shkrim Siguruesin menjehere duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, si dhe te njoftoje organet e rendit e njesite zjarrfikese. Nje njoftim i tille do te quhet i dhene Siguruesit menjehere ne se eshte derguar brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes;

b. t'i jape menjehere rajonit perkates te policise nje liste te objekteve te demtuara;

c. te shmange ose minimizojte humbjet ose demtimet me sa eshte e mundur dhe gjate ketyre veprimeve te ndjeke udhezimet e Siguruesit; i Siguruari eshte i detyruar te kerkoje dhenien e ketyre udhezimeve ne se lejojne kushtet;

d. te bllokoje librat e llogarise dhe deshmi te tjera te pasurise se tij;

e. te lejojte Siguruesin, me kerkesen e tij dhe per sa eshte e arsyeshme, te hetoje lidhur me shkakun dhe shumen e humbjes si dhe masen e demshperblimit, duke i dhene cdo informacion qe ndihmon hetimin;

f. ne se eshte e mundur, te mos ndryshojte asgje ne vendngjarje pa miratimin e Siguruesit;

g. t'i dorezoje Siguruesit brenda 10 diteve nga ndodhja e ngjarjes nje liste te firmosur te te gjitha objekteve te humbura, demtuara apo shkaterruara, sipas formularit te dhene nga Siguruesi, si dhe vleren per te cilen kerkon te demshperblehet. **54.** Nese i Siguruari, me qellim apo per neglizhence, nuk zbaton teresisht apo pjeserisht detyrimet e mesiperme, Siguruesi clirohet nga permbushja e detyrimeve te tij.

Nese organi i rendit nuk eshte njoftuar per objektet e humbura apo demtuara ne kohe, Siguruesi ka te drejte te clirohet nga detyrimi i tij vetem per keto objekte.

• DEMSHPERBLIMI

55. Nese i Siguruari perpiqet te paraqese ne menyre te shtrember ose mashtruese faktet para Siguruesit, fakte te cilat kane rendesi per mundesine ose masen e demshperblimit, Siguruesi do te clirohet nga detyrimet e tij.

56. Nese padia per demshperblim nuk eshte paraqitur ne Gjykate brenda dy vjetesh nga data qe Siguruesi e ka refuzuar ate me shkrim, Siguruesi clirohet nga detyrimet e tij.

57. Detyrimi i Siguruesit per demshperblim kufizohet deri ne masen e shumes se siguruar . Demshperblimi nuk do te jete me i larte se masa e humbjes, edhe ne se ne momentin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit shuma e siguruar eshte me e larte se vlera e sigurimit.

58. Do te demshperblehet si me poshte:

a. Ndertesat;

-ne rastin e objekteve te shkaterruara ose te humbura si pasoje e nje ngjarje sigurimi, Siguruesi do te demshperbleje vleren e siguruar sipas neneve 19 dhe 22,

-ne rastin e objekteve te demtuara si pasoje e nje ngjarje sigurimi, Siguruesi do te demshperbleje shpenzimet e riparimit qe behen te nevojshme nga demtimi, por jo me shume se vlere e siguruar sipas neneve 19 dhe 22. Kur sigurimi eshte bere ne baze te vleres aktuale do te behet nje zbritje ne perputhje me shkallen e amortizimit;

b. Makineri dhe paisje;

-ne rastin e objekteve te shkaterruara ose te humbura, Siguruesi do te demshperbleje vleren aktuale te objektit menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit sipas neneve 20 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit. Shpenzimet per transportin, koston e montimit, taksat doganore do te demshperblehen ne qofte se ne momentin e marrjes ne sigurim keto shpenzime jane perfshire vecanerisht ne shumen e siguruar;

-ne rastin e objekteve te demtuara Siguruesi do te demshperbleje shpenzimet e nevojshme qe duhet te behen per restaurimin e makines se demtuar e cila duhet te kthehet ne gjendjen e meparshme sipas neneve 20 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit, por jo me shume se vlere aktuale, menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit;

c. mallrat;

-ne rastin e objekteve te shkaterruara, te humbura ose te demtuara, Siguruesi do te demshperbleje vleren e tyre perkatese, por jo me shume se shuma e siguruar sipas neneve 21 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit.

d. nga demshperblimi do te zbritet vlere e pjeseve te mbetura ose te shpetuara;

e. nuk do te merren parasysh shpenzimet per punimet restauruese te vendosura nga autoritetet shtetore dhe shpenzimet shtese qe jane rrjedhoje e progresit teknologjik.

59. Demshperblimi maksimal qe do te paguaje Siguruesi per cdo dem nuk do te kaloje shumen e siguruar te rene dakord per sejcilin objekt.

60. Siguruesi mund te shtyje kohen e pageses:

a. per aq kohe sa ekzistojne dyshime mbi te drejten e te Siguararit per te marre pagesen;

b. ne qofte se jane filluar hetime penale ne lidhje me ngjarjen e sigurimit kunder te Siguararit;

c. per aq kohe sa i Siguruari nuk paraqet dhe ploteson dokumentat e kerkuara nga Siguruesi.

61. Pas likuidimit te demshperblimit, objektet mbeten te siguruar deri ne mbarim te afatit te kontrates se sigurimit per difference midis shumes se siguruar te paguar, duke bere per kete shenime te vecanta ne policen e sigurimit. Me kerkesen e te Siguararit, shuma e siguruar mund te rritet per te arritur shumen origjinale duke paguar prim shtese dhe duke bere shenimet perkatese ne policen e sigurimit.

62. Siguruesi brenda 30 diteve nga data e marrjes se dokumentave te demit nga i Siguruari, detyrohet qe,

a. te beje pagesen ne rast te demshperblimit

b. te shpjegoje aresyet e refuzimit, ne rast te furnizimit.

Siguruesi do te demshperbleje te Siguruarin per demin duke paguar me para, duke riparuar ose zevendesuar sipas zgjedhjes se Siguruesit.

63. Mosmarrveshjet ne qofte se nuk zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga gjykata e vendit ku eshte lidhur Polica e Sigurimit.

• **MBULIMI NGA TERMETI**

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga termeti, si dhe zjarri i cili pason termetin.

Me kusht qe:

termeti duhet te jete i regjistruar nga stacionet sizmike, si dhe te kete nje vlere jo me te vogel se 4 Balle sipas shkalles Rihter.

- ndertimi te jete bere ne perputhje me kushte sizmike te zones.
- shuma e siguruar e termetit te jete 80% e shumes se siguruar te zjarrit.

Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet:

- ne themelet e nderteses
- ne afresket dhe zbukurimet murale
- ne enet uje mbajtese te vendosura ne muret, gardhet ose rrethimet e jashtme
- lindur, shkaktuar, shtuar direkt ose indirekt nga reaksioni berthamor, rrezatimi berthamor ose ndotjet radioaktive
- shkaktuar nga permbytja, vershimi, valet e batices.

1. MBULIMI NGA VJEDHJA

OBJEKTI I SIGURIMIT

1. Siguruesi ofron Sigurimin nga Vjedhja për objektet e mëposhtme:

- **paisje e sende shtepiake** - bashkësia e mobiljeve, paisjeve e sendeve shtepiake;
- **makineri e pajisje** - pajisje, makineri, impiante të lëvizshme, veglat dhe pjesët ndërrimit e bazamentet përkatëse;
- **pajisje zyre** - bashkësia e mobiljeve, makinave, veglave e orendive që përbëjnë pajimet normale të një zyre, ose që i shërbejnë përmbushjes normale së një veprimtarie tregtare apo profesionale, si dhe impianteve të parandalimit e alarmit, kasafortat, raftet e sigurimit e të përforcuara, blloqet e kasetave të sigurimit (përfshirë përmbajtjet përkatëse), përfshirë sa treguar në përcaktimin e mallrave, sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;
- **mallra** - mallra, lëndë të para, prodhime gjysëm të gatshme, lëndë rezervë e materiale konsumi, amballazhe të brendshme e të jashtme, skarcot e mbetjet si dhe të tjera që kanë afëri me veprimtarinë e deklaruar, përfshirë sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;
- **objekte të vlefshme** - kuadro pikturë, skulptura, objekte arti që nuk janë mobilje, pelice, objekte argjendi, tapete e sixhade, përfshirë sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë e letra me vlerë;
- **sende me vlerë** - gurë të çmuar, metale të vlefshme (ar e platin) të përpunuar ose jo, objekte me metal të vlefshëm e perla natyrore;
- **letra me vlerë** - kartmonedha, tituj krediti, obligacione e lloje të tjera të letrave me vlerë.

2. Objektet që do të sigurohen do të përcaktohen në listen bashkëngjitur polices së sigurimit.

3. I Siguruari mund të sigurojë pranë Siguruesit pasuri që e ka në pronësi të tij ose në çdo formë tjetër të pronësisë me kusht që të ketë një kontratë të rregullt me pronarin e pasurisë apo të sendit

RREZIQET E SIGURIMIT

4. Siguruesi dëmshpërblen të Siguarin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar që rrjedhin nga vjedhja, vjedhja që çon në grabitje, grabitja si dhe veprimet në tentativë për kryerjen e ketyre akteve brenda objektit ose mjediset përreth.

5. Termi **vjedhje** do të aplikohet nëse një person :

- a. arrin të futet në objektin e siguruar, me thyerje;
- b. hap me forcë një kasafortë ose një konteiner brenda objektit;
- c. arrin të futet në objektin e siguruar me anë të një çelësi origjinal të cilin ai e ka vjedhur ose grabitur;
- d. futet me menyra të fshehta në objekt, d.m.th. hyn fshehtas në objekt dhe perpiqet të mos zbulohet. Sidoqoftë mbulimi do të parashikohet nëse personi le gjurmë duke dale nga objekti i siguruar, të cilat mund të perdoren si dëshmi.

6. Termi **vjedhje që çon në grabitje** do të aplikohet nëse personi është kapur në aktin e vjedhjes dhe vepron siç përcaktohen në piken 7 për të mbajtur në dorezim pasurine e vjedhur.

7. Termi **grabitje** do të aplikohet nëse:

- a. është përdorur forcë ndaj të siguarit ose njerit ndaj punonjesve të tij për të eliminuar çdo rezistencë për dorezimin e pasurisë së siguruar
- b. I siguruari ose punonjësi i tij dorezon pasurine e siguruar ose e lejon atë të merret i detyruar nga kërcënimet për dëmtim trupor ose vdekje brenda objektit të siguruar. Nëse ka më shumë se një objekte të siguruar kjo do të aplikohet vetëm për atë objekt në të cilin është kryer kërcënimet;
- c. vlerat e siguruarat janë marrë të siguarit ose punonjesve të tij sepse rezistenca e tij ose e tyre është eliminuar si pasoje e një dëmtimi fizik të tij ose të tyre nga një aksident ose shkaqe të tjera për të cilat ai ose ata nuk mund të jenë përgjegjës.

Per pikat nga 7/a deri 7/c nje pjestar I familjes se Siguruarit ne moshe ligjore te cilit I jane lene ne ngarkim vlerat e siguruara per nje periudhe te kufizuar kohe, do te konsiderohet me te njejtin status si punonjes.

8. Vetem ne baze te nje marreveshje specifike dhe perkundrejt pageses se nje primi shtese mund te sigurohen sa me poshte:

a. Shpenzimet e pastrimit dhe te zevendesimit te bravave (sidoqofte behet fjale vetem per ato brava qe jane demtuar, jo per sistemin e bravave komplet)

b. Shpenzimet per zevendesimin e dosjeve, projekteve, librave te biznesit, dosjet e kartelave dhe te dhenat.c. Vandalizmi : Termi vandalizem do te aplikohet nese sipas pikave 5/a deri 5/d nje person hyn me force ne dhomat e siguruara dhe demton ose shkaterron vlerat e siguruara.

d. Nderprerja e biznesit: Nderprerja e biznesit do te aplikohet kur aktiviteti i punes eshe nderprere pjeserisht ose plotesisht si pasoje e rreziqeve te siguruara te percaktuara ne pikat 5 deri 8.

RREZIQE TË PËRJASHTUARA

9. Sigurimi nga Vjedhja nuk mbulon dëmtimet apo humbjet që shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt prej:

a. shpërdorimit, përvetësimit, falsifikimit, mashtrimit, apo veprimeve të tjera të kryera me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguruarit, pjestarëve të familjes ose punonjësve të tij;

b. humbjeve të pashpjegueshme, zhdukjeve misterioze, mungesave në inventar, mungesave të shkaktuara nga gabimet kontabël ose në numërim gjatë inventarit;

c. vjedhjes së thjeshtë, vjedhjes nga klientët, vjedhjes me mashtrim, etj., që nuk përfshijnë dhunën e drejtpërdrejtë fizike apo psikike ndaj personave apo objekteve të siguruara;

d. manipulimit ose keqpërdorimit të pajisjeve elektronike të përpunimit të të dhënave; gjithashtu do të përjashtohen dëmet që rrjedhin nga dëmtimi i çdo lloj pajisjeje hardware e software;

e. zjarrit, eksplozionit ose çarjes së tubacioneve të ujit, edhe në se një gjë e tillë ndodh si rrjedhojë e vjedhjes;

f. tërmetit, stuhive, shpërthimeve vullkanike, përmytjeve, ndotjeve radioaktive e shpërthimit bërthamor;

g. veprimeve luftarake pavarësisht në se është shpallur lufta ose jo (përfshirë luftën civile), pushtimit ushtarak, gjendjes së luftës, terrorizmit apo sabotimit të organizuar, revoltave, kryengritjeve, grevave, trazirave popullore, turbullirave civile, eksodeve, konfiskimeve, rekuizimeve, shkatërrimeve apo dëmtimeve të kryera me urdhër të çfarëdolloj qeverie apo autoriteti shtetëror.

Të Siguruarit i bie detyrimi të provojë se dëmi i shkaktuar pasurisë së tij nuk ka lidhje me ngjarje të tilla.

10. Siguruesi nuk mbulon dëme që shkaktohen e lehtësohen me qëllim e faj nga:

- persona që banojnë me të Siguruarin dhe zenë lokalet ku ndodhen sendet e siguruara ose lokalet me të cilat komunikojnë;

-vartësit e të Siguruarit;

-të ngarkuarit me mbikqyrjen e sendeve të siguruara ose lokaleve ku ndodhen këto objekte;

-personat e lidhur me të Siguruarin në raporte farefisnie ose krushqie edhe në qofte se nuk bashkëjetojnë.

VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR

11. Vlera e sigurimit do të jetë:

a. për sendet shtëpiake, makineri dhe pajisje dhe pajisje zyre, vlera e zëvendësimit që do të konsiderohet vlera fillestare e tyre;

b. për prodhimet e gatshme e gjysëm të gatshme do të jetë çmimi i blerjes së tyre plus shpenzimet e tjera për përpunimin, deri në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit;

- c. për artikujt e përfshirë në termin mallra (përveç sa trajtuar në pikën b), objekte të vlefshme e sende me vlerë, çmimi i blerjes së tyre;
- d. për monedhat, guret e çmuar, letrat me vlerë, vlera e tyre zyrtare ne ditën e humbjes.
- e. vlera e siguruar do të jete sa vlera reale nese ne varesi te moshes, konsumit, perdorimit vlera reale eshte eshte me e vogel se 50% e kostos se zevendesimit.
- f. mbulimi per humbjen e pare do te pranohet vetem per parate, dokumentat, letrat me vlere dhe shpenzimet (8/a dhe 8/b).

Do te sigurohen te gjitha vlerat e percaktuara ne policen e sigurimit. Perjashtimi I ndonjeres prej tyre nga ana e te siguruarit nuk do te pranohet.

12. Shuma e siguruar, si rregull, do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit dhe do të jetë:

- a. për sendet shtepiake, makineri e pajisje, pajisje zyre, objekte të vlefshme e sende me vlerë, do të përcaktohet në Policën e Sigurimit, sipas listës bashkëngjitur Policës;
- b. për mallrat, në Policën e Sigurimit do të përcaktohet kufiri maksimal i mbulimit dhe në fund të çdo muaji, i Siguruari do t'i dërgojë Siguruesit një deklaratë të specifikuar për shumën maksimale të muajit. Në bazë të këtyre deklaratave, në fund të periudhës së sigurimit do të bëhet rillogaritja e shumës së siguruar për të vendosur primin që duhet paguar dhe rregullimin e diferencës përkatëse. I Siguruari mund të rrisë kufirin maksimal të mbulimit pasi ka njoftuar Siguruesin dhe ka marrë miratimin me shkrim prej Siguruesit.

- c. Ne rast te vleres se siguruar pjesore si shume e siguruar do te merret shuma ne baze te se ciles eshte llogaritur vlera pjesore.

Shuma e siguruar rritet ose zvogelohet ne fillim te çdo viti sigurimi ne perputhje me perqindjet sipas se ciles indeksi zyrtar (psh indeksi i kostos se ndertimit) eshte rritur ose zvogeluar per vitin kalendarik ne vazhdim i krahasuar me vitin e meparshem kalendarik.

TARIFA E PRIMIT TË SIGURIMIT

13. Tarifa do të caktohet për çdo grup artikujsh në bazë të këtyre kriterëve: shkallës së kriminalitetit në njësinë territoriale përkatëse, vendndodhjes së lokalit apo ambjentit të siguruar, tipit të dhomës në të cilën është vendosur pasuria e siguruar, natyrës dhe llojit të pasurisë së siguruar, shumës së siguruar, llojit të Policës së Sigurimit.

PRIMI I SIGURIMIT

14. Primi i sigurimit llogaritet duke shumëzuar tarifën e primit të sigurimit me shumën e siguruar.

15. Primi i sigurimit mund të paguhet tërësisht ose me këste, sipas këtyre rregullave:

- a. kur periudha e sigurimit është nën një vit, si rregull, primi i sigurimit do të paguhet njëherësh;
- b. kur periudha e sigurimit është 1 vit, si rregull, primi i sigurimit do të paguhet me dy këste të barabarta.

16. Në rastin e pagesës së primit të sigurimit me dy këste, data e pagesës së kështit të dytë do të caktohet jo më vonë se katër muaj nga data e pagesës së kështit të parë, sipas përcaktimit në Policën e Sigurimit.

17. Pagesa e primit ose e kësteve të tij bëhet pranë degës ose agjencisë së Siguruesit ku është lëshuar Polica e Sigurimit. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë bankare të Siguruesit.

18. Primi i sigurimit paguhet në monedhën e caktuar në Policën e Sigurimit .

19. Në rast se gjatë periudhës së mbulimit në sigurim nuk vërtetohen ngjarje sigurimi, në përtëritjen e Policës së Sigurimit për vitin pasardhës primit të sigurimit të llogaritur i bëhet zbritje në masën 10 për qind.

PJESA E ZBRITSHME

20. Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesë e zbritshme dhe franshizë.

Për çdo rast dëmi Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit në shumë absolute ose në përqindje.

Siguruesi nuk do të paguajë dëme të veçanta që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në Policën e Sigurimit.

Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizës do të përcaktohen në Policën e Sigurimit, por nuk mund të kalojë 25% të shumës së siguruar.

DETYRIME

30. I Siguruari detyrohet:

a. të zbatojë masat e rregullat e sigurimit të përcaktuara në mënyrë specifike në Policën e Sigurimit, rregullat e rekomandimet e policisë si dhe të tregojë përkujdesjen e duhur për parandalimin e dëmit; psh. në rast të largimit të të siguruarit ose persa kohe që puna në biznesin e tij është ndërprerë, dyert - duke përfshirë dyert e kasafortave - dhe të gjitha hyrjet në objekt duhet të mbahen të mbyllura gjatë gjithë kohës.

b. të regjistrojë mallin, sendet e letrat me vlerë dhe dokumenta të tjerë dhe t'i ruajë ato në kasafortë.

c. të gjitha pajisjet e sigurimit që kanë ekzistuar në kohën që është bërë kërkesa për sigurim ose për të cilat është rënë dakort për t'u pajisur me vone - në veçanti sistemi i alarmit - duhet të ruhen dhe të mbahen plotësisht në punë. I siguruari është i detyruar t'i provojë dhe t'i kontrollojë këto pajisje një herë në vit.

d. për objektet tregare duhet që parate, sendet dhe letrat me vlerë dhe dokumenta të tjera të mbahen në kasaforte gjë që plotëson kërkesat e sigurisë të përshkruara nga Siguruesi. Nëse për arsye organizimi kjo gjë nuk është e mundur, duhet të lajmerohet siguruesi me shkrim menjëherë.

SHTIMI I RREZIKUT

31. Në rast se gjatë periudhës së mbulimit në sigurim ndryshon ose shtohet rreziku, edhe nëse këto ndryshime ndodhin kundër vullnetit të të Siguruarit, ai është i detyruar që të njoftojë me shkrim Siguruesin.

32. Shtimi i rrezikut ndodh kur:

a. mjetet e sigurimit që ekzistojnë në kohën e përpilimit të kërkesës së sigurimit apo të përcaktuara në Policën e Sigurimit janë pakësuar në numër, janë zvogëluar në përmasa apo ju është pakësuar efektiviteti;

b. pasi ka humbur një çelës i hyrjes në lokal apo çelës dhome a mbajtëseje, dryni apo brava nuk është zëvendësuar me një tjetër të së njëjtës cilësi;

c. në godinën ku janë vendosur lokalet e siguruara kryhen punime ndërtimi ose riparimi, ose në ndërtesën ngjitur me të janë vendosur vinça apo pajisje të së njëjtës natyrë;

d. dhomat që kufizohen direkt me lokalin e siguruar nga lart, poshtë apo anash, rrinë përherë apo përkohësisht bosh;

e. ndërpritet përkohësisht ose përherë puna në njësinë ku është vendosur pasuria e siguruar, psh. gjatë diteve të pushimeve.

f. një venbanim që është i zënë, lihet bosh për më tepër se 60 dite pa mbikqyrje.

Pikat nga "c" deri "e" do të zbatohen vetëm për objektet tregtare.

33. Nëse shtimi i rrezikut është i tillë që, sikur gjendja e re të kishte ekzistuar dhe të ishte njohur nga Siguruesi në momentin e nënshkrimit të Policës, Siguruesi nuk do ta pranonte mbulimin e rrezikut, Siguruesi mund të zgjidhë Policën e Sigurimit dhe detyrimi i Siguruesit pushon së ekzistuari.

Siguruesi mund të zgjidhë Policën duke njoftuar me shkrim të siguruarin brenda 30 diteve nga data e marrjes së informacionit apo vënies në dijeni në rrugë të tjera për shtimin e rrezikut. Në këtë rast Polica e Sigurimit përfundon në momentin që Siguruesi dërgon njoftimin.

34. Në raste të veçanta Siguruesi mund të përjashtojë nga Polica pjesët të cilave u referohet shtimi i rrezikut, në rastin kur këto pjesë konsiderohen si të veçanta në Policë.

Nëse dëmi ndodh më parë se të kenë kaluar afatet e njoftimit dhe të zgjidhjes së Policës, Siguruesi nuk përgjigjet kur shtimi i rrezikut është i tillë që nuk do të kishte lejuar sigurimin.

35. Në se shtimi i rrezikut është i tillë që për sigurimin do të ishte kërkuar një prim më i madh, Siguruesi mund të kërkojë modifikimin e Kushteve të Sigurimit vazhdues. Në rast se i Siguruari nuk njofton pranimin e kushteve të reja brenda 15 ditësh nga data e komunikimit duke paguar primin shtesë të kërkuar, Siguruesi ka të drejtë që, sipas paragrafit të mësipërm dhe me afat paralajmërimi 15 ditor, të zgjidhë Policën e Sigurimit, ose të përjashtojë nga Polica pjesët që iu referohet shtimi i rrezikut kur këto pjesë konsiderohen si të veçanta në Policë.

Nëse dëmi ndodh më parë se të kenë kaluar afatet e komunikimit dhe të zgjidhjes së Policës, shuma që Siguruesi detyrohet të paguajë, pakësohet duke patur parasysh përpjestimin midis primit të caktuar në Policë dhe atij që do të fiksohej në se rreziku i shtuar do të kishte ekzistuar në momentin e lidhjes së Policës.

TRANSFERIMI I SENDEVE TË SIGURUARA

36. Në rast transferimi të sendeve të siguruara, i Siguruari duhet të njoftojë Siguruesin të paktën 10 ditë përpara transferimit. Në qoftëse i Siguruari nuk përmbush në kohën e duhur këtë detyrim, sigurimi mbetet i pezulluar nga ora 24 e ditës së mëparshme të transferimit dhe hyn përsëri në fuqi vetëm në orën 24 të ditës të dhjetë të mëparshme, ditë në të cilën Siguruesi ka marrë njoftim se transferimi sjell shtimin e rrezikut.

NGJARJA E SIGURIMIT

37. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i Siguruari duhet:

- a. të njoftojë me shkrim Siguruesin menjëherë, të paktën brenda 24 orëve nga momenti që është venë në dijeni të ngjarjes, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe vlerën e përafërt të dëmit, si dhe të bëjë denoncimin përkatës pranë organeve kompetente;
- b. të paraqesë Policise dhe Siguruesit, brenda 3 ditëve nga ndodhja e ngjarjes, një listë të plotë e të specifikuar të sendeve të vjedhura apo të dëmtuara me vlerat përkatëse, si dhe një kopje të denoncimit të kryer pranë organeve kompetente;
- c. të bllokojë librat e llogarisë dhe dëshmi të tjera të pasurisë së tij;
- d. të veprojë menjëherë për parandalimin ose minimizimin e dëmit ose humbjes duke ndjekur keshillat e Siguruesit, për kthimin e sendeve të vjedhura dhe për ruajtjen e atyre të mbetura, edhe pse të dëmtuara.
- e. I Siguruari është i detyruar të lejojë Siguruesin për të kryer çdo investigim në lidhje me çështjen dhe shumen e humbjes ose dëmit dhe për shkallën e dëmshperblimit, duke paraqitur çdo informacion të duhur - me shkrim nëse kërkohej - dhe dokumentat përkatëse.

38. Kur i Siguruari nuk zbaton tërësisht ose pjesërisht detyrimet sipas nenit 36, pika a, b, c, d, e, Siguruesi mund të çlirohet nga përmbushja e detyrimeve të tij.

39. I Siguruari që me qëllim nuk kryen tërësisht apo pjesërisht detyrimet sipas nenit 38 pika a, b, c, d, e, humbet të drejtën e dëmshperblimit.

40. I Siguruari që për qëllime përfitimi të padrejtë, zmadhon vlerën e dëmit, deklaron të jenë vjedhur sende që nuk ekzistojnë në momentin e ngjarjes së sigurimit, fsheh apo vë dorë mbi sende të pavjedhura, krijon dokumenta të rreme, ndryshon me qëllim gjurmët e provat materiale të krimit, humbet të drejtën për dëmshperblim.

41. Pas çdo denoncimi apo kërkesë për dëmshperblim, pavarësisht nga vlera dhe fakti nëse dëmi është i dëmshperblyeshëm ose jo, deri në ditën e 60-të nga data që dëmi që është paguar ose

përfunduar me një mënyrë tjetër, Siguruesi mund të zgjidhë Policën e Sigurimit duke paralajmëruar 30 ditë përpara të Siguarin.

EKSPERTIMI

42. Siguruesi brenda 10 ditëve nga njoftimi i të Siguarit duhet të fillojë ekspertimin e dëmit të ndodhur.

43. Në rastet kur i Siguruari nuk pranon plotësisht ose pjesërisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton atë me shkrim brenda tre ditëve nga marrja e këtij akti.

Lidhur me mosmarrëveshjen të dy palët caktojnë një ekspert tjetër ose një grup ekspertësh të përbërë nga përfaqësues të tyre ose të tretë. Eksperti ose grupi i ekspertëve të lartpërmendur nuk kanë të drejtë të riekspertojnë apo të vazhdojnë riekspertimin e filluar kur vërtetohen dëmtime të tjera të pasurisë së siguruar. Në këto kushte, procedura e ekspertimit do të rifillonte sipas pikes 42.

44. Ekspertët duhet:

- a. të verifikojnë dhe sqarojnë rrethanat e ngjarjes;
- b. të verifikojnë saktësinë e deklaratave apo përshkrimeve që rezultojnë nga aktet kontraktore dhe të përcaktojnë nëse në momentin e dëmtimit ekzistonin rrethana që kishin ndryshuar rrezikun dhe nuk ishin komunikuar;
- c. të verifikojnë nëse i Siguruari ka plotësuar detyrimet e tij;
- d. të verifikojnë ekzistencën, sasinë dhe cilësinë e sendeve të siguruara (të vjedhura ose jo);
- e. të kryejnë vlerësimin e dëmit, konform Kushteve të Sigurimit dhe Policës së Sigurimit.

KËRKESA PËR DËMSHPËRBLIM

45. I Siguruari, për marrjen e dëmshpërblimit, i paraqet Siguruesit kërkesën me shkrim, e cila duhet të tregojë edhe emrin e të Siguarit, numrin dhe datën e Policës së Sigurimit.

46. Siguruesi paguan dëmshpërblimin mbi bazën e ekspertimit përfundimtar dhe vetëm në qoftëse i paraqitet kërkesa me shkrim nga i Siguruari.

47. Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e dëmshpërblimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

48. Fillimi i afatit, në përputhje me piken 47, pezullohet për aq kohë sa dëmshpërblimi nuk mund të paguhet ose përcaktohet për shkak të të metave që ka i Siguruari.

49. Siguruesi mund të shtyjë pagesën e dëmshpërblimit:

- a, për aq kohë sa ekzistojnë dyshimet mbi të drejtën e të Siguarit për të marrë pagesën;
- b. në qoftë se është filluar çështja penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj të Siguarit ose njerit prej përfaqësuesve të tij deri në përfundimin e një procedure të tillë.

2. MBULIMI NGA PERMBYTJA

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te permbytjes.

Permbytje do te konsiderohet rasti kur:

- uji i shtratit te qendrueshem (lumit, liqenit, detit) permbyt rastesisht vendin ku eshte vendosur pasuria e siguruar, vershon duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, çan ledhet dhe digat dhe shperndahet per shkak te rrymes se ujit me nivel te larte, valeve dhe ujit te tepert nga liqenet artificiale

- vershimi i ujit per shkak te shiut te madhe, te papritur, si dhe vershimi rastesisht per shkak te rreshjeve shume te medha, gerryen gjate pjerresive, rrugeve
- tejkalohet ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore dhe nentokesore, krahas me pasojat e saj, por vetem kur kjo prek trupin e objektit ne uje. Ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore matet sipas gjendjes mujore normale te ujit ose prurjes te tij te matur ne hidromatesin me te afert. Per çdo muaj ne veçanti konsiderohet normal niveli me I larte I ujit ose prurja e tij gjate 20 viteve te fundit, perveç rasteve kur nivelet ekstremale te ujit jane tejkaluar jashte mase.
- ky sigurim mbulon vetem demet e shkaktuara ne artikujt e siguruar gjate vershimit (permbytjes) ose menjehere pasi uji ka vershuar.
- ky sigurim nuk mbulon demet per shkak te:
influences mekanike te ujit brenda tubacioneve te ujit, kanaleve, tuneleve;
kalbezimit te thate;
fundosjes, uljes se tokes, qe rrjedh nga permbytja;
ndikimit te ujit te nendheshem ne pilota, gropa themeli ose punime te ndryshme, puse miniere, koridore nentokesore dhe gropa minerare.
ujit te leshuar prej sistemeve te vaditjes, me kusht qe vershimi I tij jashte nuk eshte pasoje e permbytjes;
vendosjes te objekteve te siguruara ne shtrate lumi ose perroi te thate dhe aktive, ose ne hapsiren midis shtratit te lumit dhe bregut te lumit (hapesira e vershimit)
magazinimit te mallrave jo sipas rregullave te kerkuara
mallrave dhe produkteve te gateshme te cilat nuk jane vendosur dhe sistemuar ne rafte qe te jene te ngritura nga toka te pakten 20 cm.
- Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet ne ndertesat e ngritura mbi uje, te shkaktuar nga erozioni nga jashte; ne kanalet, tunelet ose tubacionet e ujit si dhe demet e shkaktuara nga presioni per shkak te permbytjes, n.q.s. nuk eshte rene dakort ndryshe.

3. MBULIMI NGA SHPERTHIMET OSE VERSHIME OSE RRJEDHJE NGA TUBACIONET E UJIT OSE APARATURAT

Eshte rene dakort dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga ngjarja aksidentale nga shperthimet ose vershime ose rrjedhje nga tubacionet e ujit ose aparaturat.

Referimet TUBACIONE UJI dhe APARATURA, në kuptimin e mbulimit të ofruar nga kjo shtojcë, këtu e mëposhte do të nënkuptojnë: tuba uji, tubacionet kryesore (të çesmave, të lavamaneve), depozitet e ujit ose aparatura/mjete ujërash, por duke përjashtuar:

- a) Instalimet automatike të spërkatësve dhe tubacioneve kulluese dhe
- b) Kazaneve dhe depozitave për ngrohje uji brenda shtëpive

Përjashtimet e mëposhtme zbatohen për rreziqet nga Stuhia, Shtrëngata, Përmbytja, Shpërthimet ose Vërshime ose Rrjedhje nga Tubacionet e Ujit ose Aparaturat.

Nuk do të mbulohen dëmtimet apo humbjet që:

- Vijnë si rezultat i riparimeve gjatë zhvendosjes ose ndryshimeve në tubacionet e ujit dhe të aparaturave;
- Janë rezultat i ngrirjeve nëse këto ngrirje janë rrjedhojë e neglizhencës së të siguarit;

Shkaktuar nga shpërthimet ose vërshimet ose rrjedhjet nga tubacionet e ujit ose aparaturat që ndodhin në ambientet e pabanuara, gjithsesi ky përjashtim nuk do të zbatohet gjatë periudhave në të cilat ambientet e siguruara janë të mbyllura gjatë pushimeve ose fund javave;

- Ndodhin në pasuritë e lëna jashtë (në ambientet e jashtme të godinës së siguruar);
- Ndodhin në dyert, gardhet ose muret rrethues, xhamat, kanalizimet, përrenjtë ose vijat e ujit përveçse nëse dëmi është rrjedhojë direkte e rënies së tullave apo muraturave të shkaktuar nga një rrezik i siguruar
- Vijnë si rezultat i amortizimit/kalbjes të tubacioneve të ujit apo aparaturave;
- Vijnë si rezultat i rritjes së nivelit të lagështirës
- kanë ndodhur përpara fillimit të mbulimit në sigurimit, edhe nëse ato bëhen të dukshme pas fillimit të mbulimit të siguracionit;

4.STUHIA

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te, dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te stuhise.

Stuhi do te konsiderohet nje levizje ajri me force jo me te vogel se 8 shkalle (17.2 m/s ose 62 km/ore) shkaktuar nga kushtet meteorologjike. N.q.s. nuk ka matje nga stacionet meteorologjike qe kjo force ere mbizoteronte, kur ndodh nje ngjarje, do te jete e mjaftueshme qe i Siguruari te sjell te dhena qe ne afersi te zones se siguruar, stuhia shkaktoi humbje ose deme ne ndertesat e ndertuara siç duhet ose ne objektet e tjera me rezistence te njejte ose qe duke marre parasysh konstruksionin e rregullt te nderteses, humbja ose demi te jene shkaktuar vetem nga stuhia.

Siguruesi do te paguaje demshperblimin per Objektet e Siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga stuhia, nese shkaterrimi ose demtimi:

- Shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhise.
- Shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjese te nderteses, peme ose objekte te tjera brenda objekteve te siguruara ose nderteses ne te cilen jane vendosur objektet e siguruara.
- Eshte si pasoje e humbjes ose demit te shkaktuar nga stuhia ne objektet e siguruara ose elemente te nderteses te ketyre objekteve.

Ky mbulim nuk do te shtrihet tek:

- Humbja ose demi ne ndertesat qe nuk jane gati per shfrytezim ose objekte brenda ndertesave te tilla.
- Humbja ose demi i shkaktuar nga permbytja ose orteku.
- Humbja ose demi per shkak te shiut, breshherit, debores ose hyrjes te papastertive nepermjet dritareve te cilat nuk kane qene mbyllur ose nepermjet hapjeve te tjera, ne qofte se te tilla hapje nuk jane shkaktuar nga vete stuhia.
- Humbjet ose demet e pesuara, ne sendet e fiksuara jashte objekteve te siguruara (si p.sh. sinjale, ndriçuesa neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive), linjat elektrike mbitokesore duke perfshi mbeshteteset, shtyllat ose gardhet.

5.BRESHERI

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruar, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te bresherit.

Mbulimi ne Sigurim nuk do te shtrihet tek:

- Ndertesat qe nuk jane gati per shfrytezim ose objekte brenda ketyre objekteve.
- Humbja ose demi per shkak te shiut, bresherit, debores, papastertive qe hyjne nepermjet hapjeve te tjera, nese hapje te tilla nuk jane shkaktuar nga vete bresheri.
- Humbjet ose demet e pesuara, ne sendet e fiksuara jashte, objekteve te siguruar (si p.sh. sinjale, ndriçues neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive), linjat elektrike mbitokesore duke perfshi mbeshtetset, shtyllat ose gardhet.

I Siguruari garanton mirembajtjen e rregullt te objekteve te siguruar, veçanerisht çative.

6.THYERJA ASKIDENTALE E XHAMAVE

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet deri ne masen dhe ne menyren qe parashikohet ketu e me poshte, te demshperbleje te Siguarin deri ne shumen e vendosur ne Formular ne lidhje me:

1. Thyerjen e te gjithë fleteve dhe/ose shtresave te xhamit te fiksuara ne dritaret dhe dyert e ndertesave duke perfshire pjeset e ambjentit rrethues qe jane te perfshira ne aktivitetin e Biznesit te te Siguarit te paraqitura ne Formular dhe te xhamave te jashtem te ndertesave, duke perfshire pasqyrat e fiksuara ne mure dhe xhamat e fiksuara ne vitrine (pervec dhomave frigoriferike per ushqime te ngrira).
2. Shpenzimet e zevendesimit te skeletit te dritareve dhe pajisjeve te tyre qe demtohen nga çdo shkak, por vetem ne qofte se shpenzimet e zevendesimit te ketyre skeleteve te xhamit ose pajimeve te tyre duhet te perballohen nga i Siguruari.

Perjashtimet.

Nuk do te demshperblehen:

Shkrimet e shkrojtura mbi xhama, relievimet mbi xhama, perkuljet e xhamave.

Shpenzimet e rilevizjes dhe rimagazinimit te skeleteve te dritareve si dhe te paisjeve te tyre (nese nuk perfshihen ne Formular).

Humbjet e shkaktuara nga vonesat ose nderprerja e Biznesit.

Thyerja ose demtimi qe vijne si rezultat i riparimeve, zburimeve, shtesave ose ndryshimeve ne zonen perreth qe eshte ne pronesi te Siguarit ose thyerja ose demtimi i xhamave te vendosur ne menyre korrekte dhe qe vijne si pasoje e ketyre thyerjeve ose demtimeve.

Xhamat qe konstatohet se jane demtuar para fillimit te periudhes se sigurimit si dhe çdo dem vijues i ketij demi.

Pjesa e Zbritshme e shenuar ne Formular, e cila duhet zbritur ne çdo rast thyerje ose demi.

Thyerja ose demtimi i shkaktuar nga zjarri.

K U S H T E T

Klauzola e Vleresimit.

Aty ku xhamat e ndonje lloji qe jane te siguruar sipas ketij Seksioni nuk prodhohen me, atehere vlere e xhamit te thyer do te merret sipas çmimit te fundit qe disponohet nga nje prodhues xhamash qe eshte me reputacion dhe qe prodhon xhama te ngjashem me xhamin e thyer.

Klauzola e pjeseve te shpetuara.

Ne lidhje me pagesen e demshperblimit Siguruesi ka te drejte te zbrese nga shuma e demshperblimit vleren e çdo pjese te shpetuar dhe i Siguruari me shpenzimet e tij, do te marre te gjitha masat per te ruajtur pjeset e shpetuara dhe do te levize çdo germe (a), ornament (e) dhe sende te ngjashme me to qe nuk jane te ngjitura me xhamin e demtuar.

Klauzola e Periudhes se Sigurimit dhe Shumes se Siguruar.

Periudha e Sigurimit eshte e njejte me ate te Polices se Sigurimit nga Zjarri. Shuma e Siguruar eshte e paraqitur ne Formularin e Xhamave. Kjo Shtojce si dhe Formulari i saj i bashkangjiten kesaj Police dhe jane pjese perberese e saj

7.RRESHQITJA E TOKES

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te rreshqitjes se tokes.

Ky Sigurim Mbulon humbjen ose demin per shkak te rreshqitjes se siperfaqes se tokes ne zona te pjerreta, me plasaritje dhe çarje ne forme damaresh, qe shihen qarte, te cilat ne periudha te shkurtera kohe shkaktojne deformacione statike te rrezikshme ose çarje te medha ne ndertesat.

Siguruesi çlirohet nga Detyrimi per te paguar kerkesat per demshperblim ne rastet kur:

- Zona ku eshte vendosur ndertesa ka filluar te rreshqase perpara se te leshohet Polica e Sigurimit
- Veprimet e njeriut (si hapje kanali, germime, sizmiciteti i induktuar, etj.) çojne ne nje shkeputje tektonike siperfaqesore.
- Ndodh ulje, fundosje e themeleve, cedim.
- Ndodh nje rreshqitje e vogel gjeologjike e tokes dhe qe duket ne çarje te vogla te ndertesave.
- Ka gropethithese, goditje ose shkaterrime te malit ndersa punohet nentoke apo mbi siperfaqen e tokes (karriera) neper galeri ose ballin e saj.
- Ka rreshqitje te poshtme te strukturave te reja ose vendbanimeve ose erozion bregdetar.
- Ka demtim ne ose qe duket ne levizjen e pllakave te dyshemese, nese themelet e poshtme te mureve te jashme te nderteses nuk jane te demtuara ne te njejten kohe.
- Ka demtime ne muret e pishinave, verandave, tarracave, rrugeve, portave, gardheve ose kopshteve, nese ndertesat ose ngrehinat ndihmese ose garazhdet nuk jane te demtuara ne te njejten kohe.
- Perdoren materiale difektoze ose demet qe rrjedhin nga te metat e mjeshterise gjate periudhes se ndertimit te themeleve.
- Rreshqitja ka ardhur si rezultat i permbytjes.

Ky Sigurim nuk do te mbuloje shpenzimet per permiresimin e tokes.

8.VEPRIMET (AKTET) KEQDASHESHE

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara te cilat jane shkaterruar ose demtuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashese:

Me veprime (akte) keqdashese do te kuptohet humbja, shkaterrimi ose demtimi, shkaktuar nga zjarri, eksplozioni ose te tjera) e Pasurise se siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga demtimet keqdashese te cdo personi ose grup personash.

Perjashtohen nga ky mbulim:

- a) humbja ose demtimi qe rezulton nga ndalesa totale ose e pjesshme ose nderprerja e punes, ose vonesa e punes ose I cdo lloj procesi ose operacioni tregtar ose industrial;
- b) Dëmi material apo i permbajtjes (lëndor) i Objektit të siguruar nuk do të përfshijë ne mbulim dëme në të dhëna ose software, dhe në veçanti cdo ndryshim te dëmshëm në të dhëna, software ose programe kompjuterike që shkaktohet me fshirje (deletion), prishje (manipulim–corruption) ose deformim te strukturës origjinale;
- c) humbjet (te perkohshme ose te perhershme) te pasurise se siguruar ose te cdo pjese te saj per arsye konfiskimi, rekuizimi, ndalimi ose dhunimi te kesaj pasurie, ose dhunimi I cdo pasurie perreth qe I perket te Siguruarit, cdo mjeti transporti ose sendi te ngjashem me te;
- d) humbja e te ardhurave, humbja nga vonesat, humbja e tregut ose humbja/demtimi vijues apo indirekt I cdo lloji ose pershkrimi tjetër.

Klauzola e Sanksioneve

(ri) Siguruesi nuk do të japë mbulim dhe nuk është i detyruar të paguajë ndonjë dëm apo të japë ndonjë përfitim të parashikuar në këtë kontratë, në atë masë që, pagesa e këtij dëmi apo përfitimi nga një mbulim i tillë, do të ekspozonte (ri) Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi nën rezolutat e Kombeve të Bashkuara apo sanksioneve ekonomike ose tregtare, legjislacionit të BE-së ose të Shqipërisë ose të SHBA-së (me kushtin që kjo nuk është në kundërshtim me ndonjë akt ligjor apo nën ligjor të nënshkruesit të siguruar)

Klauzola E Perjashtimit Te Demtimit Kibernetik

Dëmtimi i pronës i mbuluar nga kjo kontratë do të thotë dëmtim fizik i substancës së pronës. Dëmi fizik i substancës së pronës nuk do të përfshijë dëmtimin e të dhënave ose softuerit, në veçanti cdo ndryshim të dëmshëm në të dhënat, softweret apo programet kompjuterike që shkaktohet nga fshirja, korruptimi apo deformimi i strukturës origjinale.

Rrjedhimisht, rastet e meposhtme jane te perjashtuara nga mbulimi ne sigurim:

- a) Humbja ose dëmtimi i të dhënave ose i softwerit, në veçanti cdo ndryshim i dëmshëm në të dhënat, softweret dhe programet kompjuterike që shkaktohet nga fshirja, korupsioni ose deformimi i strukturës origjinale dhe humbjet e ndërprerjeve të biznesit që rezultojnë nga humbja ose dëmtimi i tillë.
- b) Humbja ose dëmtimet që rezultojnë nga një dëmtim në funksionin, disponueshmërinë, gamën e përdorimit ose aksesin e të dhënave, softwereve ose programeve kompjuterike, si dhe cdo humbje të ndërprerjeve të biznesit që rezulton nga një humbje apo dëmtim i tillë.

Përjashtimi i sëmundjeve ngjitëse

Kjo policë sigurimi nuk mbulon asnjë: humbje, dëmtim, përgjegjësi, kërkesë për dëmshpërblim, kosto ose shpenzim të çfarëdolloj natyre, të shkaktuar / kontribuar / që rezulton / që lind / që lidhet në mënyrë direkte ose indirekte me një sëmundje ngjitëse ose frikën ose kërcënimin (qoftë aktuale ose e perceptuar) e një sëmundje ngjitëse pavarësisht nga ndonjë shkak ose ngjarje tjetër që kontribuon njëkohësisht ose në ndonjë sekuencë tjetër të saj.

Sëmundje ngjitëse - nënkupton çdo sëmundje që mund të transmetohet me anë të çfarëdolloj substance dhe/ose agjenti nga çdo organizëm në një organizëm tjetër, ku:

1. substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet në, një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose çdo variant të tyre, pavarësisht nëse konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
2. metoda e transmetimit, qoftë direkte ose indirekte, përfshin, por nuk kufizohet në, transmetimin nëpërmjet: ajrit, lëngjeve trupore, ose transmetimin në dhe/ose nëpërmjet çdo sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngët ose gaz ose ndërmjet organizmave, dhe
3. sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose mirëqënien e njeriut ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin/ përkeqësimin